



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin

Mars, 2015


451 anëtarë të SBASHK-ut u pensionuan
SBASHK-u nderoi mësimdhënësit që u pensionuan nga 7 mars 2014 deri më 7 mars 2015



Edhe këtë 7 mars, SBASHK-u siç do vit tjetër vazhdoi traditën që për mësimdhënësit pensionistë të ndajë nga një mirënjohje dhe nga një orë dore.

.... (faqe 5)

Takime të shumta me institucionet e Kosovës
SBASHK-u do të veprojë



Listat e pagave për muajin mars u shpërndanë dhe ato ishin një dush i ftoftë për të punësuarit në tërë Arsimin...(faqe 6)

Filluan shërbime dhe këshilla juridike
SBASHK-u me avokat dhe jurist të diplomuar

Një risi tjetër me rëndësi e në shërbim të anëtarësisë së SBASHK-ut
.... (faqe 6)

Takim rreth çështjes së privatësisë në çerdhet e Prishtinës

SBASHK-u takoi të parën e DKA-së në Prishtinë


Pasi që në selinë e SBASHK-ut kishin ardhur një ... (faqe 6)

Intervistë me z.Kushtrim Biqkaj, i anëtarësuar rishtazi në SBASHK

SBASHK-u veçohet për organizim të mirë sindikal... (faqe 3)

Për ta sensibilizuar gjendjen në arsim

SBASHK-u filloi takimet me Komisionet Parlamentare



Në kuadër të këtyre përpjekjeve të SBASHK-ut gjatë muajit mars është zhvilluar edhe një takim me kryetarin e Komisionit Parlamentar...(faqe 5)

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Editorial

Harresa e qëllimshme

Muaj mars për shqiptarët rikthen kujtesën në ngjarje e data të mëdha . Ardhja e këtij muaji na kujton edhe sakrificën me shekuj e dekada të mësuesve për ta mbajtur gjallë dashurinë për gjuhën tonë e për ta përcjellë dijen e këtë dashuri mes brezave. Festa e madhe e mësuesit do të duhej të nxiste kujtesën e të gjithëve edhe për shkollën shqipe të viteve të 90-ta dhe qëndresën burrërore të mësuesve shqiptarë të Kosovës që duke sakrifikuar edhe jetën e familjen po mbanin gjallë shkëndijat e diturisë.

Më kujtohen shumë pamje e fragmente ngjarjesh të asaj kohe. Më kujtohen edhe deklaratat plot zjarr e emocione të njerëzve atëherë. Ata në takime e ndjeja për gëzime a mort mësuesit i shpallnin heronj të gjallë. Ne mësuesit ndiheshim mirë dhe na shtohej forca për të qëndruar dhe shkolla shqipe me ne e me nxënësit vazhdonte të frymonte.

Kohët e liga ikën përgjithmonë. Një pjesë e njerëzve kudo ishin me tituj e grada vazhduan me respektin për mësuesin e shkollën . Vazhduan ta nderojnë misionin e shenjtë të mësimit. Por, ka edhe nga ata që harruan punën e madhe të mësuesit në vitet '90.



Ata gjithë lavdet i kthyen në kritika. Dëgjoj nga goja e disa njerëzve që pa pasur as edhe një thirrje a titull eksperti të arsimit nisin e vlerësojnë kuturu gjendjen dhe thonë se nuk paska cilësi në arsim. Ata zhvillojnë e përhapin harresën e qëllimshme për qëndresën dhe angazhimin e dinjitetshëm e human të mësuesit nëpër dekada. Ata veprojnë sikur Kosovës nuk i duhen më mësuesit. Ata paraqiten si “mbrojtës” të shtetit e arsimit dhe kritikojnë . Ata mund të kenë edhe tituj të lartë shkencor a në pushtet, por le të pyesin vetën kush ua mësoj shkronjat e gjuhës sonë. Kush ua trasoi rrugën drejt dijes e arritjeve?

Të gjithë e dinë këtë e bëri puna e përkushtuar e mësuesit kudo në Kosovë. Atyre që po hedhin gur mbi arsimin e mësuesit po ua kujtoj një thënie të madhe : “Në Japoni të vetmit që nuk i përkulen perandorit janë mësuesit.

Japonezët mendojnë se pa mësues nuk mund të jenë perandorë”.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shitesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Në kuadër të projektit të përbashkët SBASHK-KEC “Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore”, SBASHK-u nga **1 marsi 2015** ofron shërbime juridike për anëtarët e vet.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 19.000 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Rrahman Jasharaj

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Intervista

Intervistë me z.Kushtrim Biqkaj, i anëtarësuar rishtazi në SBASHK

SBASHK-u veçohet për organizim të mirë sindikal



Kushtrimi është inxhinier i diplomuar. Ai e do shkencën dhe është shembull i mirë i punës.

I bindur se mësimdhënësit kur janë bashkë e në SBASHK, mund t'i mbrojnë më mirë të drejtat e tyre, ai pranoi të udhëheq shoqatën sindikale në shkollën e tij.

Kushtrimi ka dhënë porosi të mira për organizimin sindikal. Ai propozon më shumë trajnime për mësimdhënësit.

Arsimimi Sot :

1. Kush është Kushtrim Biqkaj?

Biqkaj :

Jam i lindur më 20.06.1983, në fshatin Hogosht, Komuna e Kamenicës. Shkollën fillore dhe të mesme i kam kryer në vendlindje. Studimet universitare i kam përfunduar në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike. Studimet master në Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri i kam përfunduar në Kolegjin UBT (Universiteti për Biznes dhe Teknologji). Punoj profesor në SHMPL "Andrea Durrsaku" që nga viti 2005.

Arsimimi Sot :

2. Çfarë e shtyri shkollën tuaj të anëtarësohet në SBASHK?

Biqkaj :

Pas debateve dhe konsultave që kemi mbajtur në shkollën tonë, kemi ndërmarr hapa konkret për organizim sindikal, dhe kemi arritur që fillimisht përmes Këshillit Grevist (që u formua pas shpalljes së grevës nga SBASHK) dhe Këshillit të Shkollës të arrijmë deri tek zgjedhja e strukturës udhëheqëse të sindikatës, e që fillimisht kemi ndërtuar një sindikatë të brendshme të shkollës. Jemi marr vesh që çdo vendim i rëndësishëm të merret nga shoqata sindikale (që e përbëjnë të gjithë anëtarët sindikatës së shkollës sonë). Duke pasur parasysh nevojën e realizimit të kërkesave të përgjithshme të të gjithë mësimdhënësve, dhe stafit tjetër nëpër shkolla si: drejtorëve, sekretarëve, punëtorëve ndihmës, etj., shkolla jonë mori vendim që t'i bashkohet SBASHK-ut. Realizimi i këtyre kërkesave burimin e saj e ka në

kontratën kolektive e cila është nënshkruar nga SBASHK dhe MASHT, e që realisht është një kontratë mjaftë e favorshme për punëtorët arsimor.

Në punëtorët e kësaj shkolle e kemi pa të arsyeshme të marrim obligime shtesë sa i përket angazhimit tonë në përmirësimin e procesit të përgjithshëm arsimor në vendin tonë, ku shtylla kryesore e një shteti padyshim se është arsimi. Angazhimi ynnë në këtë drejtim është që të kemi sindikatë kredibile dhe tepër funksionale në mënyrë që të realizojmë të drejtat e punëtorëve arsimor, dhe kjo nënkupton përmirësimin e gjendjes në arsim.

Përmes anëtarësimit në SBASHK mendojmë që do jemi edhe me afër realizimit të kërkesave tona dhe të gjithë atyre që më një formë ose me një tjetër janë të lidhur me procesin arsimor.

Arsimimi Sot :

3. Çfarë pozite në sindikatë keni?

Biqkaj :

Pozita ime në sindikatë është ajo kryetarit të sindikatës në SHMLP "Andrea Durrsaku", ku përveç kryetarit, në shkollën tonë kemi edhe kryesinë dhe këshillin mbikëqyrës që i falënderoj për punën dhe angazhimin e tyre.

Por, këtu vlen të theksohet se nuk do ishte e rëndësishme pozita, sa do të ishte e rëndësishme të ceken përgjegjësitë që kemi marr mbi vete dhe puna që do të bëjmë në të ardhmen në të mirë të të gjithë punëtorëve të shkollës sonë, si dhe kontributin në avancimin e pozitës së sindikatës e rolin e saj që do të ketë në procesin arsimor në përgjithësi. Si përgjegjësi këtu do kisha cekur transparenca dhe llogaridhënia për çdo gjë, e sidomos tek shpenzimet, pasi veç punëtorët arsimor me kontributin e tyre financiar kontribuojnë drejtpërdrejtë në funksionimin normal të sindikatës. Shpenzimet duhet të jenë në funksion të anëtarëve të sindikatës dhe këto mjete të destinohen për qëllime sindikale, dhe asnjëherë të mos shfrytëzohen në mënyrë jo të drejtë nga individ ose grupacione të caktuara brenda sindikatës. Këtë po e ceki pasi kjo mos-përgjegjësi e ul kredibilitetin dhe me të drejtë shfaqet edhe mosbesimi ndaj udhëheqësve sindikal nga anëtarët e sindikatës.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Arsimimi Sot :

4. Sa është përfshirja e të rinjve dhe femrave në arsim në komunën tuaj?

Biçkaj :

Si në çdo komunë tjetër edhe në komunën tonë përfshirja ose pjesëmarrja e të rinjve dhe femrave në arsim, nuk është në nivelin e duhur dhe shpesh mund të themi larg normave e standardeve. Megjithatë gjendja është premtuese, ku bëhen përpjekje të vazhdueshme nga institucionet komunale dhe organizata joqeveritare, por edhe nga sindikatat që së pari të afrohen kushte që të rinjtë dhe femrat të arsimohen mirë dhe t'i jepet mundësia këtyre kategorive të përfshihen dhe kontribuojnë drejtpërdrejtë në arsim, për edukimin e gjeneratave pasuese.

Në këtë drejtim mendoj që edhe SBASHK-u duhet që përmes projekteve konkrete të jap kontribut në përmirësimin e kësaj dukurie që me të vërtetë është një problematikë dhe brengë për gjithë shoqërinë.

Arsimimi Sot :

5. Cilat trajnime do t'ia propozonit SBASHK-ut për anëtarësinë e vet?

Biçkaj :

Gjithmonë ka nevojë për trajnime të reja, që në formë direkte do të ndikonte në avancimin e procesit mësimor. Duhet të bëhen analiza më të hollësishme, të komunikohet me gjithë anëtarët e SBASHK-ut, të diskutohet problematikat dhe vështirësitë me të cilat ata përballen gjatë punës së tyre. Konform kësaj, lindin edhe kërkesat për trajnime të reja që realisht do të përfitonin të gjithë ata që në një formë ose tjetër janë të lidhur me arsim. Këtu do të doja edhe të shtoja se trajnimet duhet të jenë përmbajtjesore dhe të mos keqpërdoren fondet të destinuara për këtë qëllim, e që realisht dyshimet janë se kanë ndodhur në të kaluarën. Pra, këto trajnime të arrijnë efektin e duhur, t'i kontribuojnë arsimit, ta rrisim efikasitetin dhe të garantojnë avancim të procesit mësimor.

Unë do veçoja trajnimet që kanë të bëjnë me teknologjinë e informacionit, që si mësimdhënës të jemi në trend me zhvillimin e teknologjisë dhe zbatimin e saj në proceset edukativo-arsimore. Trajnime duhet të ketë edhe sa i përket metodikës dhe didaktikës në mësimdhënie, e sidomos për mësimdhënësit që kanë filluar të punojnë këto vitet e fundit.

Arsimimi Sot :

6 Çfarë do të veçonit për të mirë në SBASHK?

Biçkaj :

Çështja më e rëndësishme është që të kemi sindikata funksionale dhe në shërbim të plotë të anëtarësisë së vetë. SBASHK-un këtu e shohim se është në rrugën e duhur për me qenë një sindikatë fleksibile karshi kërkesave të punëtorëve arsimor. Me nënshkrimin e kontratës kolektive SBASHK ka arritur një objektiv kryesor, ndërsa i mbetet qeverisë të marr obligimet e saj kundrejt kësaj kontrate dhe zbatimin e plotë të saj.

SBASHK-u veçohet për organizim të mirë sindikal, duke pasur parasysh rrethanat e përgjithshme në të cilat ndodhet vendi dhe kërkesat e tyre të realizohen përmes komunikimit e dialogut me institucionet gjegjëse. Po ashtu, vlen të veçojmë për të mirë SBASHK-un në punën e saj për arritjen e shumë marrëveshjeve me kompani të ndryshme e që janë në interes të anëtarësisë së vet.

Arsimimi Sot :

7. Ku informoheni për punën dhe aktivitetet e SBASHK-ut?

Biçkaj :

Puna dhe aktivitet e SBASHK-ut realisht duhet të prezantohen, në mënyrë që të interesuarit të kenë informata të mjaftueshme. Për punën dhe aktivitetin e SBASHK-ut informohemi përmes mjeteve të informimit, si atyre elektronike po ashtu edhe atyre të shkruara, uebfaqes së SBASHK-ut, por edhe takimeve të drejtpërdrejta që i kemi me kryetarin e SBASHK-ut, z. Jashari për çka edhe e falënderojmë shumë për punën dhe angazhimet e Tij, që të kemi një sindikatë në shërbim të të gjithë punëtorëve arsimor.

Arsimimi Sot :

8. A keni diçka për të shtuar ?

Biçkaj :

Kërkoj nga të gjithë punëtorët arsimor të vazhdojnë të japin kontributin e tyre, që të kemi një sindikatë unike dhe tepër funksionale që të jetë në shërbim të të gjithë punëtorëve arsimor. Vetëm të bashkuar mund të arrijmë rezultatet e duhura si në kërkesat tona, po ashtu edhe në realizimin e qëllimit që të kemi një arsim sa më cilësorë dhe të jetë afër standardeve evropiane. Kjo është forma më e mirë që të arrijmë objektivat tona për të cilat kanë kontribuar shumë

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Gjatë muajit

451 anëtarë të SBASHK-ut u pensionuan

SBASHK-u nderoi mësimdhënësit që u pensionuan nga 7 mars 2014 deri më 7 mars 2015



Edhe këtë 7 mars, SBASHK-u siç do vit tjetër vazhdoi traditën që për mësimdhënësit pensionistë të ndajë nga një mirënjohje

dhe nga një orë dore.

Kjo orë dhe kjo mirënjohje ka vlerë kujtese e respekti për punën e madhe të mësimdhënësit në edukimin e brezave, për kontributin e veçantë në sistemin e arsimit dhe veprimtarinë sindikale.

Në këtë 7 mars, SBASHK-u nderoi 451 anëtarë të SBASHK-ut, të cilët janë pensionuar në periudhën nga 1 prill 2014 deri me 31 mars 2015.

Ceremonia e ndarjes së mirënjohjeve dhe orëve të dorës u organizua nëpër të gjitha nivelet komunale.



Listën e kolegëve të pensionuar për këtë vit mund ta gjeni në këtë link :

http://www.sbashk-rks.org/pensionistet_2015_per%20link.xlsx

Respekt për të gjithë mësimdhënësit tanë.

Për ta sensibilizuar gjendjen në arsim

SBASHK-u filloi takimet me Komisionet Parlamentare

Në kuadër të këtyre përpjekjeve të SBASHK-ut gjatë muajit mars është zhvilluar edhe një takim me kryetarin e Komisionit Parlamentar për Arsim, z. Nait Hasani.



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe menaxheri financiar, Ymer Ymeri, kanë njoftuar z.Hasani për shqetësimet e arsyeshme të SBASHK-ut duke i deklaruar se nëse nuk implementohet 0.5 % për çdo vit shërbimi në listat e pagave të marsit, atëherë SBASHK-ut nuk i mbetet gjë tjetër veçse ta ftojë anëtarësinë në grevë të përgjithshme dhe Qeveria është ajo që do të mbetet përgjegjëse për problemet që do të krijohen. Ata kanë lutur z. Nait Hasani për angazhime që të bëhet zgjidhja ashtu si ishte thënë në ofertën e MASHT-it, ofertë kjo që u pranua nga mësimdhënësit dhe bëri që të pezullohet greva, porse ajo mund të riaktivizohet në rast të mospërmbushjes së ofertës. Kryetari e Komisionit Parlamentar për Arsim, z. Nait Hasani ka premtuar se do të angazhohet me gjithë mundësitë që çështja të zgjidhet në mënyrë që të mos

ketë nevojë për veprime sindikale. Ai është shprehur i gatshëm për bashkëpunim me SBASHK-un në shërbim të arsimit në Kosovë dhe një gatishmëri të tillë e ka dëgjuar edhe nga SBASHK-u.

Një delegacion i SBASHK-ut ka marrë pjesë edhe në punimet e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Kryetarja e këtij Komisioni të Parlamentit të Kosovës, znj. Flora Brovina dhe anëtarët tjerë të Komisionit kanë dëgjuar me kujdes prezantimet e SBASHK-ut që kishin të bënin me gjendjen momentale në arsim dhe me dialogun social. Ata kanë thënë se Parlamenti duhet të amandamentojë Ligjin mbi Këshillin Ekonomiko Social dhe t'ua mundësojë sindikatave reale të jenë pjesë e këtij Këshilli në të cilin zhvillohet dialogu trepalësh. SBASHK-u ka deklaruar se po të ishin sindikatat reale e të fuqishme pjesëmarrëse në KES , pjesë e të cilit janë edhe pesë (5) Ministri, mes tyre edhe MASHT, atëherë do të zhvillohej një dialog i vërtetë dhe i frytshëm dhe nuk do të vinte vendi në situata të vazhdueshme plot tensione e greva.

Kryetarja Brovina dhe anëtarët tjerë të këtij komisioni kanë shtruar edhe pyetje dhe janë zotuar se çështjet e ngritura nga delegacioni i SBASHK-ut do t'i kenë si bazë të mirë për angazhime në të ardhmen lidhur me çështjet që lidhen punën e Komisionit të tyre Parlamentar.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC





Takime të shumta me institucionet e Kosovës

SBASHK-u do të veprojë

Listat e pagave për muajin mars u shpërndanë dhe ato ishin një dush i ftohtë për të punësuarit në tërë Arsimin e Kosovës. Në listat nuk ishte 0.5 % për vitet e shërbimit. Kryetari, Kryesia dhe Këshilli Drejtues i SBASHK-ut do të jenë të obliguar të veprojnë sipas kërkesës së mësimdhënësve të Kosovës e ajo kërkesë është e qartë dhe sipas të gjitha gjasave do të shkohet në grevë të përgjithshme, e cila do të vazhdojë deri në realizimin e kërkesave.

Kujtojmë se SBASHK-u nuk i ka ndalur gjatë gjithë kohës përpjekjet që në takime me Institucionet e përmes dialogut të arrihet deri të realizimi i kërkesave të të punësuarve në arsimin e Kosovës. Është zhvilluar komunikim të vazhdueshëm me MASHT-in, është takuar me Zv/Kryeministrin z. Kujtim Shala, me kryetarin e Komisionit Parlamentar për Arsim, z. Nait Hasani. Në këto takime SBASHK-u ka përsëritur se Qeveria duhet të implementojë 0.5 % për çdo vit shërbimi në listat e pagave të muajit mars. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë kujtuar në çdo takim me institucionet se ata duhet të angazhohen në realizimin edhe të 3 kërkesave

tjera nga Kontrata Kolektive, pra të kompensimit prej 70% të biletave të udhëtimit për mësimdhënësit udhëtarë, të 3 pagave për mësimdhënësit me rastin e pensionimit të tyre dhe të shujtës në shumën prej 2 eurosh për çdo ditë pune. Kështu edhe ishte marrëveshja dhe oferta e MASHT-it që ndikoi për pezullimin e grevës. U kërkuar vazhdimisht edhe një takim me Ministrin Abrashi dhe fillimisht nga kabineti i tij ishte caktuar edhe dita e takimit, por më vonë Ministri Abrashi nuk i është përgjigjur kërkesës së SBASHK-ut për takim e dialog. Gjithnjë kjo dëshmon se SBASHK-u ka zhvilluar shumë aktivitete e angazhime për të gjetur zgjidhje për gjithë kërkesat e të punësuarve në arsimin e Kosovës, por nga ana tjetër kemi pasivitetin dhe mos angazhimin e Qeverisë për realizimin me kohë të kërkesave legjitime e të drejta të mësimdhënësve është vështirë të shpjegohet. Ajo që dihet është se SBASHK-u do të veprojë dhe për këtë vendoset në Këshillin Drejtues sipas vullnetit dhe kërkesës së të punësuarve në arsimin e Kosovës.

Filluan shërbime dhe këshilla juridike

SBASHK-u me avokat dhe jurist të diplomuar



Një risi tjetër me rëndësi e në shërbim të anëtarësisë së SBASHK-ut është angazhimi përmes Projektit KEC –SBASHK “*Fuqizimi i rolit*

të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore” të një avokati të licencuar, i cili do të kryej falas shërbime juridike për anëtarët e SBASHK-ut.

Në shërbim të dhënies së përgjigjeve profesionale për gjitha çështjet dhe pyetjet që shtrijnë mësimdhënësit këtë muaj është angazhuar përmes Projektit të njëjtë edhe një Jurist i diplomuar, që do të ndihmojë avokatin e licencuar.

Pyetjet mund ti shtroni përmes ueb-faqes sonë, në këtë link :

<http://sbashk-rks.org/index.php/per-ne/pyetje-dhe-pergjigje>

Takim rreth çështjes së privatësisë në çerdhet e Prishtinës

SBASHK-u takoi të parën e DKA-së në Prishtinë



Pasi që në selinë e SBASHK-ut kishin ardhur një delegacion i edukatoreve të çerdheve të Prishtinës dhe kishin shprehur shqetësimin e tyre lidhur me lajmin se në çerdhe

do të instalohen kamera vëzhguese edhe në dhomat e punës, kryetari i SBASHK-ut, z.Rrahman Jasharaj bashkë me kryetarin e SAF e SAM për Prishtinë, z.Ahmet Pllana, kanë vizituar DKA-në në Prishtinë dhe janë takuar me Drejtoreshën e kësaj DKA-je, znj. Arbërie Nagavci.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Delegacioni i SBASHK-ut ka informuar znj. Nagavci me shqetësimin e edukatoreve. Ajo ka deklaruar se ka qenë një ide për kamerat në çerdhe, por DKA-ja dhe pushteti lokal në Prishtinë

nuk do të veprojnë pa bashkëbiseduar me të gjitha palët dhe ashtu si do të arrihet marrëveshja e përbashkët edhe do të veprohet.

Anëtarësia e SBASHK-ut po rritet

Vetëm nga shkollat e Prizrenit 348 anëtarë të rinj



Angazhimi i vazhdueshëm, bashkëbiseda me punëtorët e arsimit dhe puna e përkushtuar

në qendër e nëpër komunat e Kosovës ka bërë që SBASHK-ut t'i shtohet vazhdimisht numri i anëtarëve. Në muajin e kaluar SBASHK-u ka 730 anëtarë të rinj, nga të cilët 348 janë nga Komuna e Prizrenit. Shumica nga këta po anëtarësohen për herë të parë dhe janë zotuar se do të angazhohen me përkushtim që të kthehen në një forcë unike në mbrojtje të kërkesave të të punësuarve në arsim. Ata shprehen se të bashkuar e me një mision të qartë të SBASHK-ut më lehtë mund të mbrohen e realizohen kërkesat e tyre. Ajo që gëzon është se në SBASHK u rikthye SHMLP "Adrea Dursaku" e Kamenicës.

Një delegacion nga kjo shkollë ka vizituar selinë e SBASHK-ut dhe ata kanë sjellë edhe listat e anëtarësisë nga shkolla dhe raportin se atje është mbajtur takimi i mësimdhënësve dhe se janë formuar edhe organet e kësaj shoqate. Ky delegacion është shprehur se po kthehen me vendimin e të gjithë mësimdhënësve të kësaj shkolle pasi ata kanë vërejtur ndryshime pozitive dhe angazhime të singerta të Kryesisë së SBASHK-ut dhe veprimtarëve sindikal nëpër komuna. Ata kanë lavdëruar SBASHK-un për 100 marrëveshjet për zbritje çmimesh të shërbimeve me bizneset dhe me institucionet private shëndetësore. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përgëzuar kolegët nga SHMLP "Adrea Dursaku" dhe iu ka premtuar angazhim të vazhdueshëm bashkë me ta e gjithë anëtarët tjerë në mbrojtje të kërkesave të mësimdhënësve të Kosovës.

Disa nga aktivitetet sindikale në komuna

Sindikatat komunale gjatë këtij muaji

Në këtë numër të gazetës elektronike "Arsimimi Sot", po paraqesim disa nga aktivitetet e tri komunave gjatë muajit mars 2015.

Deçan - z. Avdullah Lataj (Kryetar i SAF & SAM në këtë komunë)



SBASHK-u edhe në Deçan ka vazhduar me traditën për të shprehur respekt për mësimdhënësit e pensionuar e në kujtesë të ditës së madhe të mësuesit. Kryetari i SAF e SAM për komunën e Deçanit, z. Avdulla Lataj bashkë me veprimtarët të tjerë sindikalë u kanë shpërndarë mësimdhënësve të pensionuar nga një mirënjohje dhe nga një orë dore në shenjë respekt për punën e tyre të përkushtuar me dekada në arsimimin e brezave. Ky aktivitet është bërë bashkë me nismën e kryetarit të

komunës z. Rasim Selmanaj, për shpërndarjen e mirënjohjeve më rastin e 7 Marsit ditës së mësuesit në shenjë falënderimi për veprimtari jetësore të mësimdhënësve të pensionuar në mes të dy 7 Marseve, 2014-2015, traditë kjo tashmë e komunës sonë për të nderur këtë kategori të mësimdhënësve që më punën e tyre dhe kontributin e dhënë në fushën e Arsimit i dhanë hovë zhvillimit edukativo arsimor. Mirënjohjet u shpërndanë në bashkëpunim me drejtorin e DKA-së z. Qazim Maloku.



Implemented by:

Hani i Elezit–

z. Basri Dernjani (Kryetar i SAF & SAM në këtë komunë)



Sindikata komunale Hani i Elezit gjatë muajit mars 2015 ne vazhden e aktiviteteve të saja javore me shoqatat sindikale në nivel shkollash nuk rreshti së punuari në disa aktivitete duke potencuar disa pre tyre si: takime me biznese të ndryshme në të mirë të anëtarësisë, e ky takim të shpie në finalizimin e

marrëveshjes me dy barnatore vendase për ulje të çmimeve të barnave për 10 %.

Po ashtu gjatë muajit mars, gjegjësisht ditës së mësuesit sindikata komunale në bashkëpunim me sindikatat e shkollave dhe drejtorinë komunale të arsimit ka bashkë-organizuar një darkë me mësimdhënësit e komunës sonë, duke participuar Sindikata 50 %, ndërsa drejtoria komunale e arsimit 50 % .

Rahovec - z. Murat Kryeziu (Kryetar i SAF & SAM në këtë komunë)

Aktivitetin sindikal në komunën e Rahovecit,e përcjellin shumë veprimtari dhe shumë suksese,nga ardhja në krye të kësaj dege të z. Murat Kryeziu.

Dihet se e vetmja komunë e cila nuk ka gene pjesë e SBASHK-ut gjer në vitin 2013,ka qenë komuna e Rahovecit. Kjo komunë e pati pushuar veprimin sindikal,dhe falë angazhimit të pashoq të kryetarit të tanishëm,kjo komunë ka arritur që në gjirin e vet ti ketë të gjitha shkollat dhe atë në përqindje deri 97 %.

Kryesia e kësaj dege ka aktivitete mujore,dhe po qe nevoja edhe javore e ditore.



Kështu gjatë muajit mars 2015,nga aktiviteti i kësaj Dege,po përmendim vetëm disa,që na merr mendja se flasin shumë për këtë degë të SBASHK-ut.

Së pari vlen të përmendet aktiviteti i

kësaj dege,me rastin e pensionimit të një numri të punëtorëve të kësaj komune. Në restaurantin “Haxhijaha” në Rahovec, u mbajt takimi i radhës me kryetarët e Sindikatës nga shkollat fillore dhe ato te mesme nivel dege, ku prezent përveç kryetarëve të sindikatave të shkollave ishin edhe shtatëmbëdhjetë ish veteranët e arsimit tani të pensionuar brenda një viti.

Në një atmosferë të ngrohtë e dashamirësi, përfaqësuesit e lartpërmendur në praninë edhe të përfaqësuesit nga DKA-ja, z.Vesel Krasniqi, kryetari i sindikatës ne nivel komunal z.Murat Kryeziu, i përshëndeti në radhë të parë ish

Veteranët e Arsimit, “ata që për një jetë të tërë dhanë më shumë se shumë për gjenerata të tëra, që ta ndritin rrugën e dijes, për të ndërtuar kalanë e mendjes, për të ngritur vetëdijen e brezave për një gjysmë shekulli” siç thotë Kryeziu. Gjithashtu ai përshëndeti përfaqësuesin e DKA-së, z.Krasniqi, dhe kryetarët e të gjitha shkollave nga Sindikata.

Më pas Kryeziu, tha: “S’vlejnë fjalët, janë të pakta para atyre që vepruan një jetë të tërë për të mposhtur errësirën dhe robërinë shekullore, këta ishin qirinj të pashuar që bënë dritë në ditët më të vështira, këta e varrosën aparteidin shekullor mbi tokën arbërore” përfundoi Kryeziu.

M.Kryeziu, kryetar nga Dega në Rahovec, nuk hezitoi t’i përmend edhe pesë shkolla fillore dhe një të mesme, të cilat janë anëtarësuar një numër mjaft i madh në sindikatë, duke mos dyshuar se në këtë mënyrë do t’i kërkojnë dhe do t’i mbrojnë të drejtat e tyre.

Nga shkolla fillore “Isa Boletini” në Rahovec u anëtarësuan 62 veta, “Katër Dëshmorët” në Ratkoc, 35 anëtarë , “Faik Konica”, Celinë, 32 anëtarë, “Mustafë Ibishi”, në Kramovik, 27 anëtarë, “Dëshmorët e Zatriqit”,12 anëtarë, si dhe më rastin e mëvetësisë së Shkollës së Mesme Profesionale “Selajdin Mullabazi – Mici” në Rahovec, nga 14 anëtarë sa kishte iu shtuan edhe 14 anëtarë të rinj qe do të thotë,tani numëron 28 anëtarë nga 30 punëtorë sa kishte shkolla.

Duhet cekur se numri i anëtarëve po rritet dita më ditë edhe nëpër shkollat tjera falë angazhimit dhe aktivitetit të vet kryetarit të Degës z.Murat Kryeziu. Kjo veç shihej nga takimet e vet kryetarit Kryeziu, me kreun e komunës z.Idriz Vehapi, me ish

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



drejtorin Rama, tani znj.Vjollca Vuçitërna, drejtuese e DAK-ut dhe takimet me kryetaret e shkollave.

Interesimi i mësimdhënësve në nivel dege po rritet falë premtimeve të MASHT-it,përkatësisht Kryesisë së SBASHK –ut,dhe këmbëngulësisë së kryetarit,gjegjësisht Kryesisë,në nivel komunal, qe Kontrata Kolektive të zbatohet përpikërisht në të kundërtën mësimdhënësit ndërrojnë mendje.

Në takimin e lartpërmendur foli edhe njëri nga ish veteranët e arsimit, veprimtari i ditëve të para në arsim, ish drejtori i DKA-së, z.Shaban Dana, por ky tani sikur e ka mundur padrejtësia, apo më mirë të themi zhgënjimi për një gjysmë shekulli punë për gjenerata të tëra, e tani siç thotë ai “po pensionohemi apo po vdesim” ngaqë nuk heziton të thotë:- “Ne pishtarët e ditëve më të vështira, po

kthehemi me 75 euro në shtëpi, mos vallë do të bëhemi lypës dikush, po mos ta kishim mbështetjen e familjarëve” përfundoi z.Dana.

Në fund në nivel dege, kryetari i Sindikatës, z.M.Kryeziu, ndau mirënjohje për të gjithë mësimdhënësit qe shkuan në pension, po ashtu , secili nga ata mori dhuratë edhe nga një orë dore të blerë nga SBASHK-u.

Mund të themi se ky takim është parë në sy të mirë, gjë qe duhet vazhduar, mirëpo si më këtë rast do të ishte mirë thanë ata “qe të jetë prezent edhe ndonjë nga përfaqësuesit e Sindikatës Qendrore”.

Takimi përfundoi duke marrë ca fotografi qe të ruhen kujtim për të ardhmen në mes shokëve të arsimit nga ana e Sindikatës në nivel komunal.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut flasin për gjendjen në arsim

SBASHK-u u takua me përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar



Jackues Miniane, Frank Lakvijk, Giuseppe Cipollone, Json Veis, Aleksandra Zdzienicka, dhe Florian Misch në cilësinë e

përfaqësuesve të lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar janë duke zhvilluar takime pune me përfaqësues të institucioneve shtetërore, me liderë të partive politike dhe me sindikatat.

Të enjten e fundit të muajit mars, ata janë takuar me delegacionin e SBASHK-ut dhe kanë shprehur vlerësimet e tyre lidhur me gjendjen momentale në Kosovë dhe lidhur me mundësitë reale buxhetore . Ata kanë kërkuar që sindikatat të veprojnë me maturi dhe të angazhohen në ruajtjen e qetësisë sociale.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe menaxheri Financiar, Ymer Ymeri u kanë treguar përfaqësuesve të lartë të FMN-së për situatën



në Arsimin parauniversitar duke e cilësuar atë si të tensionuar dhe me mundësi që të shpallet grevë e përgjithshme. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë sqaruar me argumente pse

ka ardhur deri të një moment i tillë duke i dhënë theks të veçantë mungesës së angazhimit të Qeverisë për realizimin e marrëveshjeve dhe pikave të Kontratës Kolektive. Përfaqësuesit e FMN-së kanë deklaruar pastaj se greva është e drejtë legjitime dhe e garantuar me Ligje e Konventa vendore e ndërkombëtare. Ata kanë shtuar se do t'i deklarojnë qeveritarëve dhe përfaqësuesve të tjerë të institucioneve se duhet shtuar mjete nga buxheti për arsimin në përgjithësi në mënyrë që të krijohen kushte edhe më të favorshme për punë dhe arritje cilësore.

SBASHK-u merr pjesë në trajnim të organizuar nga zyra BE-së në Kosovë

Trajnim mbi Menaxhimin financiar dhe vizibilitetin e projekteve të BE-së



trajnim mjaft të qëlluar në ambientet e

Me ftesë të zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, SBASHK-u mori pjesë në një

organizatës TACSO (Asistenca Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile), me trajner z.Fatmir Bytyqi .

Në këtë trajnim pjesëmarrës ishin shumë organizata të ndryshme, të cilat janë në implementim të projekteve që financohen nga zyra e BE-së në Kosovë, duke përfshirë edhe

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC





KEC-in (Qendra për Arsim e Kosovës) që jemi partner të projektit "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore", projekt ky i financuar nga zyra e BE-së. Nga ana e SBASHK-ut pjesëmarrës ishin menaxheri financiar Ymer Ymeri dhe asistentja Vlora Rexhepi Berisha. Vlen të theksohet se ky trajnim kishte mbledhur pjesëmarrës nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia.

Disa nga objektivat e këtij trajnimi ishin që pjesëmarrësit të kenë informacion të përgjithshëm mbi menaxhimin e granteve të financuara nga BE në kuadër të Programeve Ndërkufitare, të njohin rregullat e aplikuara sipas një marrëveshje granti të BE-së (EuropeAid), duke nisur që nga dhënia e grantit deri në përfundim të tij, të zgjerojnë njohuritë e tyre mbi procedurat kontraktuale dhe financiare të EuropeAid dhe të jenë të aftë të aplikojnë këto rregulla me qëllim mënjanimin e rreziqeve financiare, të jenë të aftë të gjejnë informacionin relevant në dokumentet ligjore si dhe të kuptojnë përfitimet e përdorimit të rregullt të këtyre procedurave.

Marrëveshje të reja

Arriti në 100 numri i marrëveshjeve për zbritje çmimesh

Përveç angazhimeve të përditshme në prezantimin sa më të denjë të kërkesave të të punësuarve në arsim, SBASHK-u vazhdon aktivitetin për lidhjen e marrëveshjeve me bizneset e institucionet shëndetësore private për zbritje çmimesh të shërbimeve e mallrave.



Gjatë këtij muaji arritëm edhe shumë marrëveshje të reja për zbritje çmimesh, si marrëveshja me Kompaninë e njohur

"AL Petrol" e cila iu ofron të gjithë të punësuarve në arsim e që janë anëtarë të SBASHK-ut, zbritje prej 3 centë në litër të derivateve dhe zbritje prej 12 % për produktet tjera si vajra, antifriz, uji i xhamave e produkte të tjera.



SBASHK-u po ashtu në partneritet me Meridian Express dhe të mbështetur nga projekti "Përkrahje

Partnerëve Social" nënshkruan marrëveshje për zbritje çmimesh prej 3% të shumicës së artikujve për anëtarët e SBASHK-ut.

Rrjeti i marketeve të lagjes Meridian Express, i njohur me moton "N' derë të shtëpisë", për ofrimin e produkteve cilësore dhe ofertave më të mira në treg, Meridian Express nënshkruan marrëveshjen e fillimit të bashkëpunimit me SBASHK, duke i ofruar të gjithë anëtarëve të sindikatës zbritje në blerjet që ata bëjnë në të 33 marketet Meridian Express në gjithë territorin e vendit.



Z. Rrahman Jasharaj, Kryetar i SBASHK-ut dhe Z. Agon Gashi, Drejtor Ekzekutiv i Meridian Express, e vlerësuan shumë

këtë bashkëpunim, i cili do t'i ofrojë sindikalistëve të SBASHK-ut çmime të volitshme në blerjet që bëjnë në marketet e Meridian Express. Ky bashkëpunim u cilësua si partneritet mjaft i suksesshëm dhe krijon bazë shumë të

rëndësishme për zhvillimin e projekteve të reja mes dy palëve në të ardhmen. Bashkëpunimi i arritur mes SBASHK-ut dhe Meridian Express është mbështetur nga projekti "Përkrahje Partnerëve Social", i cili i vjen në ndihmë dialogut social në Kosovë. Në kuadër të këtij projekti, sindikatat e mëdha të Kosovës, ndër të cilat edhe SBASHK-u, janë pajisur me ID kartela digjitale të anëtarësisë, mbi të cilat do të bëhet edhe zbatimi i lirimeve në 33 supermarketet e rrjetit të Meridian Express.

Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni Meridian Express

Tel: +386 49 731 9060

E-mail: yllka.mustafa@meridianexpress.com

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC

